

VENDIM
Nr. 278, datë 3.4.2013

PËR MIRATIMIN E MINIMUMIT TË SPECIFIKIMEVE TEKNIKE TË PAJISJEVE TË LOTARISË KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 31 të ligjit nr. 10 033, datë 11.12.2008 “Për lojërat e fatit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. PARIME TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka për qëllim vendosjen e minimumit të specifikimeve teknike për pajisjet e Lotarisë Kombëtare dhe përcaktimin e kriterëve që shërbejnë për organizimin, të cilat duhet të sigurojnë se:

- a) sistemi të veprojë në përputhje me rregullat tregtare të Republikës së Shqipërisë;
- b) sistemi përmbush qëllimet e përgjithshme të përcaktuara në ligj.

2. Pajisjet e Lotarisë Kombëtare, për të qenë të ligjshme për përdorim, duhet të përmbushin specifikimet minimale teknike, sipas këtij vendimi. Asnjë pajisje nuk do të përdoret nga i licencuari për veprimtarinë e Lotarisë Kombëtare, nëse ajo nuk është certifikuar dhe/ose miratuar si pajisje nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

3. Sistemi i ngritur për realizimin e Lotarisë Kombëtare duhet të jetë një sistem kompjuterik me kapacitet të mjaftueshëm për përpunimin e të dhënave, ruajtjen e tyre, për ndërfaqen e komunikimit, si dhe për arkivimin e të dhënave me qëllim që të mund t’i ekzekutojë me efikasitet të gjitha detyrat për implementimin dhe zhvillimin e procesit të lotarisë. Gjithashtu, duhet të bëhet e mundur vendosja e një lidhjeje të sigurt komunikimi midis sistemit qendror dhe pajisjeve fundore.

4. Sistemi duhet të bëjë të mundur:

- a) komunikimin e çdo pajisjeje fundore drejtpërsëdrejti me serverin qendror;
- b) regjistrimin e çdo të dhëne të dërguar nga terminalët, leximin nëpërmjet terminalit të të dhënave identifikuese të biletave dhe përcaktimin nëse një biletë është fituese apo jo, pas hedhjes së shorteut;
- c) përpunimin dhe raportimin e të dhënave;
- ç) që pajisjet e Lotarisë Kombëtare të veprojnë në mënyrë lehtësisht të kontrollueshme, të besueshme dhe të sigurt;
- d) kryerjen e vetëkontrolleve të këtij sistemi;
- dh) kryerjen e kontrollit të sigurisë;
- e) kryerjen e kontrollit financiar.

II. PAJISJA QENDRORE (SERVERI)

1. Në kuptim të këtij vendimi, sistem qendror (server) quhet tërësia e serverëve, pajisjeve fundore (terminaleve), sistemi kompjuterik dhe rrjeti (network-u).

2. I licencuari duhet të instalojë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë një pajisje qendrore (server), të bazuar në një sistem të kompjuterizuar, i cili duhet të ketë kapacitetin e mjaftueshëm (në procesim të dhënash) që të kryejë me efektshmëri të gjitha veprimet e lidhura me organizimin e lotarisë, si dhe detyrimet ligjore.

3. I licencuari duhet të dokumentojë të gjithë komponentët e serverëve qendrorë, sipas skedave teknike të prodhuesit, të identifikojë komponentët thelbësorë të këtij sistemi dhe t’i paraqesë paraprakisht për miratim Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit në tërësi serverat qendrorë dhe komponentët e tyre. Quhen komponentë thelbësorë komponentët (por pa u limituar vetëm në to), si më poshtë vijon:

- a) memoria përpunuese e sistemit;
- b) fuqia proceduese e sistemit;
- c) kapaciteti i magazinimit të të dhënave.

4. I licencuari duhet të depozitojë kërkesën për miratim pranë Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave

të Fatit për çdo pajisje në serverat qendrorë, si për çdo komponent, ashtu edhe në total në rastin kur serverat e përdorur janë të assembluar nga prodhuesi. Gjithashtu, duhet të depozitohet për miratim pranë Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dokumentacionin e prodhuesit së bashku me deklaratën doganore të importit (në rast se pajisja është e importuar).

5. Pajisjet fundore ose терминаlet, të cilat janë pajisje të përdorura nga i licencuari, me qëllim leximin dhe printimin e biletave, duhet të bëjnë të mundur kryerjen e veprimeve të mëposhtme:

- a) çdo terminal i lidhur të jetë i identifikueshëm në serverin qendror;
- b) të lexojnë përzgjedhjen e numrave sipas përkëmbimeve të vendosura nga lojtari;
- c) të transferojnë të dhënat në serverin qendror në kohë reale;
- ç) të printojnë biletat dhe të dhënat e lexuara sipas formatit të miratuar nga Ministria e Financave;
- d) të konfirmojnë pas skanimit të biletës së luajtur dhe të marrin përgjigje nga serveri qendror nëse kjo biletë është apo jo fituese.

III. SOFTWARE

1. Software-i i të licencuarit duhet të bëjë të mundur:

- a) identifikimin e çdo terminali të lidhur në sistem;
- b) mbledhjen e të gjitha të dhënave të ardhura nga pajisjet fundore në kohë reale;
- c) ruajtjen sipas legjislacionit në fuqi dhe të këtij vendimi të të dhënave të mbledhura;
- ç) përpunimin, sipas kërkesave ligjore, kërkesave të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe të të licencuarit, të informacionit të mbledhur;
- d) arkivimin e të dhënave të mbledhura;
- dh) gjenerimin për çdo biletë të printuar nga pajisjet fundore të një numri rendor unik gjatë gjithë periudhës së licencimit.

2. Software-i duhet të parashikojë një procedurë vetëkontrolli, me anë të së cilës të kontrollohet që sistemi dhe çdo veprim i kryer nga ai është në përputhje me funksionimin e qëllimin e organizimit të lojës.

3. Çdo informacion për hyrjet në sistem duhet të regjistrohet nga i licencuari. Të gjitha të dhënat për hyrjet në sistem duhet të mblidhen në format elektronik. Ndërhyrjet e dyshimta duhet t'i raportohen Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

4. Në sistemin qendror nuk lejohet të instalohen *software* që nuk shërbejnë për organizimin e Lotarisë Kombëtare dhe nuk kanë lidhje me këtë aktivitet.

5. Software-i i të licencuarit duhet të jetë i aftë të gjenerojë raporte. Këto raporte duhet të jenë në format elektronik dhe të jenë të eksportueshme minimalisht në *excel* dhe *pdf*. Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit duhet t'i bëhet e mundur në çdo moment të gjenerojë raporte nga sistemi i të licencuarit, qoftë nga distanca (*on line*) qoftë në vend (*on site*). Raportet ndahen në dy kategori:

- a) raporte për ngjarje (evente) të sistemit;
- b) raporte për performancën dhe detyrimet ligjore të të licencuarit për zhvillimin e Lotarisë Kombëtare.

6. Në raportet për ngjarje të sistemit përfshihen të paktën rastet kur:

- a) sistemi nuk vepron sipas rregullave të vendosura në këtë vendim apo sipas rregullores së të licencuarit dhe indikacioneve të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit;
- b) sistemi, për arsye të ndryshme, pjesërisht apo plotësisht, nuk është në funksionim (*sistem down*);
- c) sistemit i është bërë *back-up* dhe ky sistem funksionon me *filet e back-up-it*;
- ç) kryhen punime apo testime të sistemit;
- d) çdo aplikacion vetëkontrolli sinjalizon një anomali.

7. Në raportet e performancës përfshihen të paktën:

- a) numri total i shitjeve dhe vlera në lekë e biletave, progresiv, gjatë gjithë periudhës së licencimit dhe i ndarë ky sipas nëntotalit për muaj/shorte/qark/terminal/tipologji loje;
- b) çmimet e fituara nga lojtarë, të ndara gjatë gjithë periudhës së licencimit sipas nëntotalit muaj/shorte/qark/terminal/tipologji loje. Gjithashtu, duhet të jetë dhe për çmimet e patërhequra nga fituesit dhe *jackpot*-i i caktuar;

c) detyrimet financiare në rend mujor/vjetor dhe gjatë gjithë periudhës së veprimtarisë, të ndara në zëra sipas detyrimeve që i licencuari ka ndaj Njësies së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, detyrime ndaj administratës tatimore. Këto raporte duhet të jenë të veçanta për çdo kategori loje që organizon i licencuari;

ç) numri i pikave të shitjes dhe adresat e tyre duke përfshirë çdo ndryshim.

8. Përveç raporteve të përcaktuara në pikat 6 dhe 7, nëse Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit e gjykon të arsyeshme, i licencuari duhet të gjenerojë edhe raporte të tjera për të dhënat e ruajtura në sistemin e Lotarisë Kombëtare.

9. I licencuari duhet të sigurojë që përgjatë ose në përfundim të periudhës së licencimit, me kërkesë të Njësies së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, të ofrojë të gjitha ekstraktet e nevojshme të ruajtura në databazën e tij për të siguruar vijueshmërinë e pagesave të çmimeve në një mënyrë të përshtatshme. Gjithashtu, i licencuari duhet të mundësojë kalimin për tek i licencuari pasardhës të të gjitha të dhënave të nevojshme në lidhje me biletat ende të vlefshme.

10. Nëse kërkohet nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, i licencuari duhet të sigurojë integritet të sigurt të sistemeve të jashtme me sistemin e Lotarisë Kombëtare nëpërmjet ndërfaqeve të jashtme të programuara ose nëpërmjet platformës së interoperabilitetit. Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe çdo organ tjetër i caktuar me ligj duhet të kenë akses leximi në bazën e të dhënave të të licencuarit.

IV. RRJETI

1. Kjo pjesë përmbledh specifikimet minimale teknike për komunikimin e të dhënave brenda sistemit qendror, mes sistemit qendror dhe pajisjeve fundore, si dhe të sistemit qendror e palëve të treta.

2. Çdo komunikim elektronik ndërmjet sistemit qendror dhe pajisjeve fundore apo palëve të treta duhet të kalojë në të paktën 1 sistem mbrojtjeje (*firewall* apo të ngjashëm).

3. I licencuari duhet të sigurohet që çdo informacion që kalon në rrjet të jetë i kriptuar për sa i përket veprimtarisë së Lotarisë Kombëtare.

4. Me qëllim miratimit nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit të rrjetit të të licencuarit duhet të paktën që ky i fundit të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

a) skemën e rrjetit (infrastrukturën);

b) skemën e kriptimit të informacionit;

c) procedurat dhe mjetet e rilevimit të ndërhyrjeve të paautorizuara dhe procedurat në rast sulmi nëpërmjet rrjetit.

V. SIGURIA

1. Serverat qendrorë duhet të jenë të vendosur në një ambient të mbyllur e të siguruar, hyrja në të cilin mund të bëhet vetëm nga personel i autorizuar. I licencuari duhet të mbajë regjistër elektronik dhe shkresor për çdo person i cili hyn në këtë ambient, për arsyet e hyrjes, veprimet që kryhen brenda ambientit dhe kohëzgjatjen e qëndrimit në ambient. Një sistem alarmi duhet të jetë i ngritur me qëllim evidentimin e hyrjes së paautorizuar.

2. Të gjitha pajisjet elektrike/elektronike të sistemit qendror, si dhe pajisjet ndihmëse për funksionimin e tij (ndriçim, sistemi i kondicionimit të ajrit, linja telefonike etj.), duhet të jenë të lidhura me pajisje të tilla që të sigurojnë mbrojtjen e sistemit nga luhajtje të rrymës elektrike dhe vazhdimësi të funksionimit të sistemit në rast të shkëputjes së energjisë elektrike. Në rast të ndërprerjeve të gjata të energjisë elektrike, pajisje të tilla, si gjenerator, duhet të vihen në funksionim për të evituar fikjen e sistemit qendror.

3. Të gjitha pajisjet e instaluar në ambientet e pajisjes qendrore duhet të jenë të tokëzuara. Të gjitha sistemet e emergjencës (si p.sh. UPS-ja, gjeneratori, ndriçimi i emergjencës etj.), duhet të testohen të paktën 1 (një) herë çdo tre muaj, duke mbajtur shënim datën, orën dhe procedurën e testimit. Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit mund të kërkojë dërgimin e një specialisti të tij për pjesëmarrjen në testim, si dhe të kërkojë nga i licencuari regjistrin e plotë të testeve.

4. Në rast se mungesa e rrymës vazhdon tej kapacitetit të pajisjeve që sigurojnë vazhdimësinë e rrymës, por jo më pak se 24 (njëzet e katër) orë, duhet të bëhet e mundur fikja e sistemit qendror në mënyrë korrekte, pa pasur humbje të të dhënave, si dhe duhet të vihet në funksionim sistemi që ndodhet

në qendrën e vazhdueshmërisë së biznesit (*Business Continuity Centre*).

5. Qendra e të dhënave primare, ku do të vendoset sistemi qendror, duhet të jetë e pajisur me sistemin e duhur të kondicionimit dhe ventilimit, sistem kamerash që inkuadrojnë çdo hapësirë të ambientit (brenda dhe jashtë tij, 24/7/365), sistem monitorimi të ndryshimit të parametrave të brendshëm (si: temperatura, lagështia etj.), sistem për dedektimin e zjarrit etj. Qendra e të dhënave primare duhet të jetë sipas standardeve më të mira kombëtare dhe ndërkombëtare. Filmimet e regjistruara duhet të ruhen për 30 (tridhjetë) ditë.

6. I licencuari duhet të ngrejë një procedurë informimi për çdo ngjarje në serverin qendror. Gjithashtu, duhet të parashikohen procedura për zgjidhjen sa më të shpejtë të problemit. Një regjistër me çdo avari apo problem të lindur me sistemin duhet të mbahet dhe t'i vihet në dispozicion Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit sa herë që ky i fundit e gjykon të arsyeshme.

7. I licencuari për Lotarinë Kombëtare duhet të sigurojë mbrojtjen me antivirus dhe/ose “*firewall*” kudo ku ekziston rreziku i infektimit me viruse (apo mjete të ngjashme), sulm kibernetik etj.

8. I licencuari i Lotarisë Kombëtare duhet të ngrejë dhe një sistem “*back-up*-i” në një ambient, të ndryshëm nga ai i pajisjes qendrore, për të parandaluar humbjen e të dhënave.

9. I licencuari për Lotarinë Kombëtare nuk mund t'i ndryshojë karakteristikat teknike dhe specifikimet e pajisjeve, pa miratimin paraprak të Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

10. Aplikacionet, baza e të dhënave dhe sistemi operativ duhet të jenë të mbrojtura me fjalëkalime (*password*).

11. Për çdo sulm apo keqpërdorim të sistemit, i licencuari duhet të ketë procedura për raportim të Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit, si dhe procedura për ndjekjen e zgjidhjen e problemit. Sulmet ndaj sistemit të sigurisë janë të paktën:

- a) përpjekje e paautorizuar për të hyrë në sistem;
- b) përpjekje e paautorizuar për ndryshim të dhënash;
- c) përpjekje e paautorizuar për të ndryshuar konfigurimin e sistemit apo sigurisë së tij, rregullave të lojës, bazës së të dhënave etj.

I licencuari duhet të sigurohet se ruajtja e fjalëkalimeve është e kriptuar dhe të ketë një regjistër me të dhënat e hyrjes në sistem të çdo përdoruesi, kompetencat e tij sipas rangut dhe veprimeve të kryera nga ky i fundit në sistem.

12. Regjistrimi dhe ruajtja e logeve duhet të kryhet nga i licencuari dhe të ruhet përveçse në sistemin qendror edhe në atë të emergjencës (*back-up*). Në këto të dhëna duhet të paktën të përfshihen:

- a) të gjitha të dhënat/transaksionet e rëndësishme, të ruajtura me datën dhe orën e kryerjes;
- b) logimet dhe baza e të dhënave që duhet të jenë të dublikuara (në sistemin qendror dhe në një sistem (*back-up*);

c) të gjitha rregullimet, modifikimet dhe vendosjet e biletave të lojës për shorteun së bashku me identifikimin e modifikuesit/vendosësit dhe datën/orën e modifikimit/vendosjes.

Baza e të dhënave duhet të ruhet të paktën 3 (tre) vjet. Të dhënat që kanë apo mund të kenë efekte financiare duhet të ruhen të paktën 5 (pesë) vjet.

13. Në raste fatkeqësie (zjarri, përmbytjeje etj.), i licencuari duhet të sigurojë ruajtjen e të paktën të dhënave financiare dhe që kanë lidhje me shorteun. Këto të dhëna të jenë të rikuperueshme deri në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë. I licencuari duhet të bëjë të paktën çdo ditë një *back-up* të sistemit dhe të të dhënave të rëndësishme në sistemin e emergjencës (*back-up-it*).

14. I licencuari duhet të sigurojë që, në rast fatkeqësie dhe pasi të konstatojë që sistemi nuk mund të rikuperohet në asnjë mënyrë tjetër, të bëjë *back-up*-in nga dita e mëparshme dhe të jetë në gjendje të rikuperojë të dhënat e rëndësishme sipas përcaktimeve të vendosura nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

VI. PAJISJA QË SHËRBEN PËR HEDHJEN E SHORTEUT

1. Pajisja që shërben për hedhjen e shorteut (goglave) duhet të jetë e certifikuar nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit dhe me pullën e sigurisë së vendosur nga kjo e fundit. Me qëllim certifikimin e kësaj pajisjeje, duhet të dorëzohet pranë Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit

dokumentacioni i mëposhtëm:

a) certifikatë nga prodhuesi;
b) certifikatë testimi të prodhuesit, e cila certifikon se pajisja i tërheq goglat në mënyrë të rastësishme;

c) njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit apo çdo organ tjetër i përcaktuar me ligj mund të testojë pajisjet e hedhjes së shortit në çdo kohë.

2. Nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit i vendoset pullë sigurie çdo seti me gogla, i cili do të përdoret nga i licencuari. Çdo set me gogla (nga 0 deri në 39), i mbyllur në kutinë përkatëse, i dërgohet për miratim Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit. Pasi ky i fundit vëren se pesha dhe diametri i goglave është brenda limitit të pranueshëm ($\pm 1.1\%$ për diametrin, bazuar në diametrin mesatar të të gjitha goglave të setit përkatës dhe $\pm 2.1\%$ për peshën, bazuar në peshën mesatare, të të gjitha goglave të setit përkatës) dhe nuk ka në to asnjë deformim, i cili mund të ndikojë në daljen e rastësishme të tyre, vendos pullën e sigurisë dhe mbyll kutinë. Në rast se i licencuari vendos se duhet të ndërrojë setin e goglave, këtë mund ta bëjë vetëm me një tjetër set të miratuar nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

3. Një përfaqësues i Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit duhet të jetë gjithnjë prezent në hedhjen e shorteut nga i licencuari. Ndër të tjera, përfaqësuesi kontrollon se goglat dhe pajisja e përdorur janë ato të miratuara dhe të certifikuara nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit. Detyrat e tjera të përfaqësuesit vendosen nga rregullorja e lojës së të licencuarit dhe nga Drejtori i Përgjithshëm i Njesisë së Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

4. Në rastin kur i licencuari e zhvillon shorteun në mënyrë elektronike, aplikimet duhet të jenë instaluar në server të veçantë, që duhet të plotësojnë të gjitha kërkesat e sigurisë. Të gjitha pajisjet dhe aplikimet duhet të miratohen nga Njësia e Mbikëqyrjes së Lojërave të Fatit.

5. Pika 1 e këtij kreu është e vlefshme edhe në rastin kur i licencuari e zhvillon shorteun në mënyrë elektronike (jo me gogla) apo në çdo lloj mënyre tjetër.

VII. DISPOZITA TË FUNDIT

Vendimi nr. 682, datë 11.6.2009 i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e minimumit të specifikimeve teknike të pajisjeve të Lotarisë Kombëtare”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha